

# *Etapat e mendimit sociologjik*

*Raymond Aron*

*Përktheu nga frëngjishtja,*

*Masar Stavileci*

## *Pjesa e parë*

Themeluesit

CHARLES-LOUIS DE SECONDAT

BARON DE MONTESQUIEU

Do ta quaja veten njeriun më të lumtur,  
po të kisha mundësinë të bëja që njerëzit  
të mund të shëroheshin nga paragjykimet e tyre.  
Quaj këtu paragjykime, jo atë që e bën njeriun  
të mos njohë disa gjëra, por atë që e bën të mos njohë vetveten.

Fryma e ligjeve, parathënie.

Mund të duket e habitshme që një histori e mendimit sociologjik të fillojë nga studimi për Monteskjënë. Në Francë, ai quhet përgjithësisht pararendës i sociologjisë, por Ogyst Komtit i është dhënë merita për themelimin e saj - me arsye, në qoftë se themelues do të quhet ai që ka krijuar termin. Por, nëse sociologun do ta përcaktonim sipas *qëllimit specifik*: njohja shkencore e marrëdhënieve shoqërore, atëherë Monteskjë është, sipas meje, sociolog po aq sa Ogyst Komti. Interpretimi i sociologjisë, i përfshirë në *Frymën e ligjeve*, është, në të vërtetë, më "modern" në disa pikëpamje se ai i Ogyst Komtit. Kjo nuk vërteton që Monteskjë ka përparësi ndaj Ogyst Komtit, por Monteskjë, për mendimin tim, nuk është pararendës, por njëri nga doktrinarët e sociologjisë.

Për ta konsideruar Monteskjënë sociolog, duhet t'i përgjigjemi pyetjes, të cilën e kanë shtruar të gjithë historianët: me ç'disiplinë është marrë Monteskjë? Cilës shkollë i përket ai?

Lëkundja është e dukshme në sistemin universitar francez. Monteskjë mund të figurojë njëkohësisht në programin e agregacionit të letërsisë, të filozofisë e madje, në disa raste, edhe të historisë.

Në një nivel më të lartë, historianët e ideve radhisin , njëri pas tjetrit, Monteskjënë midis letrarëve, midis teoricienëve të politikës, midis historianëve të drejtësisë, midis ideologëve, të cilët, në shekullin XVIII, vunë në diskutim themelet e institucioneve franceze dhe përgatitën krizën revolucionare, madje edhe midis ekonomistëve.<sup>1</sup> Është shumë e vërtetë që Monteskjë është njëkohësisht shkrimtar, pothuaj romancier; jurist; filozof i politikës.

„Megjithatë, nuk ka dyshim që në veprën e tij të përgjithshme, *Fryma e ligjeve* zë një vend qendror. Për mua objekt i *Frymës së ligjeve* ka gjasa të jetë objekt që do ta përkufizoja si sociologjik.

Për më tepër, Monteskjë nuk e fsheh fare këtë. Ai synon ta bëjë historinë të kuptueshme. Ai kërkon ta kuptojë të dhënë historike. Por, e dhëna historike i paraqitet atij në formën e një diversiteti, pothuajse të pakufishëm, dokesh, shprehish, idesh, ligjesh, institucioneve. Pikënisja e kërkimit është pikërisht ky diversitet, në dukje inkohorent. Qëllimi i kërkimit do të duhej të ishte zëvendësimi i këtij diversiteti inkohorent me një rend të përfytyruar. Monteskjë kërkon, pikërisht si Maks Veberi, të kalojë nga të dhënat inkohorente

në një rend të kuptueshëm. Ja, kjo ecuri është ecuria e mirëfilltë e sociologut.

Mirëpo, dy termat e sapo përdorur, *diversitet inkoherent*, *rend i kuptueshëm*, me siguri paraqesin problem. Si do të arrijmë të gjejmë një rend të kuptueshëm? Cila do të jetë natyra e këtij rendi të kuptueshëm, i cili ka zëvendësuar *diversitetin radikal* të dokeve dhe zakoneve?

Më duket se në veprën e Monteskjesë ka dy përgjigje, që nuk janë në kundërshtim me njëra-tjetrën ose, më mirë të themi, dy etapa të një ecurie.

E para ka si qëllim të pohojë se pas kaosit të rastësive gjenden shkaqe të thella të cilat shpjegojnë irracionalitetin e dukshëm të ngjarjeve.

Në *Përsiatje mbi shkaqet e madhështisë dhe të rënies së romakëve*, Monteskje shkruan kështu: “Nuk është fati ai që sundon botën. Mund t’i pyesni për këtë romakët, të cilët patën një varg të pandërprerë mbrothësish, kur u qeverisën sipas një plani, dhe një varg të pandërprerë fatkeqësish, kur vepruan sipas një tjetri. Në çdo monarki veprojnë shkaqe të përgjithshme qoftë morale, qoftë fizike, të cilat e lartësojnë, e ruajnë ose e përmbysin. Të gjitha rastësitë u nënshtrohen këtyre shkaqeve dhe, në qoftë se fati i një beteje, domethënë një shkak i veçantë, ka rrënuar një shtet, ka pasur një shkak të përgjithshëm, i cili ka ndikuar që ky shtet të zhduket nga një betejë e vetme. Shkurt, ecuria themelore bëhet shkaktare e të gjitha rastësive të veçanta.” (kap. XVIII, vep. e cit. vëll. II, f. 173).

Dhe në një vend tjetër, në *Frymën e ligjeve*:

“Nuk qe aspak beteja e Poltavës ajo që shkatërroi Karlin XII. Në mos atje, ai do të kishte pësuar disfatë gjetiu. Rastësitë e fatit ndreqen lehtë. Nuk mund t’u bëhet ballë ngjarjeve që lindin vijimisht prej natyrës së gjërave.” (Lib. X, kap. 13, vep. e cit. vëll. II, f. 387).

Mendimi që del nga këto citate është, më duket, mendimi i parë i pastër sociologjik i Monteskjesë. Do ta formuloj kështu: pas vargut të ngjarjeve, në dukje të rastësishme, duhen kuptuar shkaqet e thella të cilat i shpjegojnë ato.

Një parashtrim i tillë nuk do të thotë, megjithatë, se gjithçka që ka ngjarë, ka qenë rrjedhim i pashmangshëm i shkaqeve themelore.

Sociologjinë nuk e përkufizon, në pikënisje, postulati, sipas të cilit rastësitë nuk veprojnë në rrjedhën e historisë.

Dhe vërtet, puna është që të shihet nëse shkaktar i një fitoreje apo disfate ushtarake është korruptimi i shtetit apo një lajthitje teknike ose taktike. Nuk është provë e qartë se cilado fitore ushtarake do të ishte shenjë e madhështisë së një shteti apo cilado disfatë, shenjë e korrupsionit të tij.

Përgjigjja e dytë e Monteskjësë është më interesante dhe shkon ca më larg. Ajo nuk synon të tregojë që rastësitë shpjegohen nëpërmjet shkaqeve të thella, por që diversiteti i dokeve, zakoneve dhe ideve mund të organizohet brenda një numri të vogël llojesh. Ndërmjet diversitetit të pakufishëm të zakoneve dhe njësisë absolute të një shoqërie ideale, ka një rrugë të mesme.

Parathënia e *Frymës së ligjeve* e shpjegon qartë këtë mendim thelbësor:

“Së pari kam shqyrtuar njerëzit me kujdes dhe kam menduar se ata, në atë diversitet ligjesh e dokesh, nuk udhëhiqeshin vetëm prej trilleve të tyre.”

Formulimi i këtu kuptohet që larmia e ligjeve është e shpjegueshme, sepse ligjet e çdo shoqërie janë përcaktuar prej disa shkaqeve, të cilat veprojnë ndonjëherë edhe pa vetëdijen e njerëzve.”

Pastaj, ai vazhdon:

“Kam shtruar parimet dhe kam parë se si rastet e veçanta u nënshtrohen atyre në mënyrë të vetvetishme; se si historitë e të gjitha kombeve nuk janë tjetër veçse pasoja të tyre; dhe se si çdo ligj i veçantë lidhet me një ligj tjetër, ose varet nga një ligj tjetër më i përgjithshëm.” (Vep. e cit. vëll. II, fq. 229)

Kështu, diversitetin e respektuar të zakoneve mund ta shpjegojmë në dy mënyra: nga njëra anë, duke iu kthyer shkaqeve, që janë përgjegjëse për ligjet e veçanta, të cilat respektohen në një rast apo në një rast tjetër; nga ana tjetër, duke nxjerrë parime ose lloje që përbëjnë një nivel të ndërmjetëm mes diversitetit inkohorent dhe një skeme përgjithësisht të vlefshme. *Ndryshimi* bëhet i kuptueshëm kur rroket *shkaqet* e thella që e kanë përcaktuar ecurinë e përgjithshme të ngjarjeve. *Diversiteti* bëhet i kuptueshëm, kur të organizohet brenda një numri të vogël llojesh ose konceptesh.

## ***Teoria politike***

Problemi i aparatit kuptimor të Monteskjësë, i atij aparati që i jep mundësi për të zëvendësuar një rend të përfytyruar me një diversitet inkohorent, pothuaj i kthehet përsëri çështjes, klasike për interpretuesit, të planit të *Frymës së ligjeve*. A na ofron apo jo kjo vepër një rend të kuptueshëm apo një përmbledhje vërejtjesh pak a shumë të gjetura mbi këto ose ato aspekte të realitetit historik?

*Fryma e ligjeve* ndahet në shumë pjesë, natyra heterogjene e të cilave është konstatuar shpeshherë. Nga pikëvrotimi im, më duket se ka tri pjesë të mëdha.

Së pari, trembëdhjetë librat e parë që zhvillojnë teorinë e mirënjohur të tre llojeve të qeverisjes, domethënë të asaj që ne do ta quanim sociologji politike, që është një përpjekje e tij për të grupuar diversitetin e formave të qeverisjes në disa lloje, meqë secili prej këtyre llojeve është përkufizuar, njëkohësisht, sipas natyrës dhe parimit të tij.

Pjesa e dytë shtrihet në librat XIV-XIX. Ajo u është kushtuar shkaqeve materiale ose fizike, domethënë kryesisht ndikimit të klimës dhe të vendit mbi njerëzit, doket dhe institucionet e tyre.

Pjesa e tretë, që kap librat XX deri XXVI, studion me radhë ndikimin e shkaqeve shoqërore, të tregtisë, të parasë, të numrit të njerëzve, të fesë, mbi doket, zakonet dhe ligjet.

Këto tri pjesë janë pra, me sa duket, nga njëra anë sociologji e politikës, nga ana tjetër, studim sociologjik i shkaqeve, disa fizike, disa morale, të cilat veprojnë mbi organizimin e shoqërive.

Përveç këtyre tri pjesëve kryesore, mbesin librat e fundit të *Frymës së ligjeve* të cilët, meqë i janë kushtuar studimit të legjislacioneve romake e feudale, paraqesin ilustrime historike, dhe libri XXIX, i cili është vështirë t'i bashkohet njëres nga ndarjet e mëdha; ky kërkon t'i përgjigjet pyetjes: si duhen hartuar ligjet? Ky libër i fundit mund të interpretohet si përpunim pragmatik i rrjedhimeve që dalin nga studimi shkencor.

Ka më së fundi një libër, të cilin është vështirë ta rendisim në këtë plan të përgjithshëm, dhe ky është libri XIX, që ka si objekt studimi

frymën e përgjithshme të një kombi. Ai nuk përmban asnjë shkak të veçantë ose aspekt politik të institucioneve, por përmban atë që mbase përbën parimin e *njësimit* të tërësisë shoqërore. Sidoqoftë, ky është ndër librat më të rëndësishëm. Ai paraqet kalimin ose lidhjen midis pjesës së parë të “Frymës së ligjeve”, sociologjisë politike, dhe dy pjesëve të tjera, të cilat studiojnë shkaqet fizike ose morale.

Me anë të parashtrimit të këtij plani të *Frymës së ligjeve* na mundësohet të paraqiten problemet thelbësore të interpretimit të Monteskjësë. Të gjithë historianëve u kanë bërë përshtypje dallimet ndërmjet pjesës së parë dhe dy pjesëve që vijnë pas. Sa herë që konstatojnë natyrën në dukje heterogjene të pjesëve të të njëjtit libër, historianët janë të prirë të kërkojnë ndihmë nga interpretimi historik për të gjetur datën, kur i ka shkruar autori pjesët e ndryshme.

Në rastin e Monteskjësë, interpretimi historik mund të zhvillohet pa shumë vështirësi. Librat e parë të *Frymës së ligjeve*, në mos i pari, të paktën nga libri II deri tek libri VIII, domethënë librat që përimitojnë tre llojet e qeverisjes, janë, në qoftë se mund të them, të frymëzimit aristotelian.

Monteskjë i ka shkruar ato para udhëtimit në Angli, në kohën kur ishte nën ndikimin zotërues të filozofisë politike klasike. Por,, *Politika* e Aristotelit ishte libri kryesor në traditën klasike. Nuk ka dyshim që Monteskjë i ka shkruar librat e parë me *Politikën* e Aristotelit pranë. Pothuajse në çdo faqe mund të gjenden referime në formë aluzioni ose kritike.

Librat e tjerë, në veçanti libri i famshëm XI, mbi kushtetutën e Anglisë dhe ndarjen e pushteteve, janë shkruar, me gjasë, më vonë, pas qëndrimit në Angli, nën ndikimin e shënimeve nga ky udhëtim. Për sa u përket librave të sociologjisë, kushtuar studimit të shkaqeve fizike ose morale, ata janë shkruar, me sa duket, më vonë se librat e parë.

Prandaj, do të ishte lehtë, por jo fort e arsyeshme, të paraqitet *Fryma e ligjeve* si puqje e dy mënyrave të mendimit, e dy mënyrave të studimit të realitetit.

Monteskjë do të ishte, nga një pikëpamje, dishepull i filozofëve klasikë. Si i tillë, ai ka zhvilluar një teori të llojeve të qeverisjes, e cila, edhe pse dallon në disa pika nga teoria klasike e Aristotelit, u përket

ende ambientit dhe traditës së këtyre filozofëve. Njëkohësisht, Monteskjë do të ishte një sociolog, i cili kërkon të gjejë ndikimin që klima, natyra e vendit, numri i njerëzve dhe feja mund të ushtrojnë mbi aspektet e ndryshme të jetës kolektive.

Duke qenë autori, nga njëra anë, teoricien i politikës dhe, nga ana tjetër, sociolog, *Fryma e ligjeve* do të ishte një vepër inkoherente dhe jo një libër i renditur sipas një qëllimi mbizotërues dhe sistemi konceptual, sado që përmban pjesë që u përkasin datave dhe mbase frymëzimeve të ndryshme.

Para se t'i nënshtrohem një interpretimi që e supozon historianin më inteligjent se autorin dhe të aftë për të parë menjëherë kundërshtinë që do t'i kishte shpëtuar gjenit, duhet të kërkojmë rendin e brendshëm që Monteskjë, me ose pa dashje, ajgëtonte në mendimin e tij. Problemi i shtruar ka të bëjë me pajtueshmërinë ndërmjet teorisë së *llojeve* të qeverisjes dhe teorisë së *shkaqeve*.

Monteskjë dallon tre lloje të qeverisjes: republikën, monarkinë dhe despotizmin. Përkufizimi i secilit prej këtyre llojeve u referohet dy koncepteve, që autori i *Frymës së ligjeve* i quan *natyrë* dhe *parim* i qeverisjes.

Për vetë natyrën e saj, qeverisja është ajo që e bën atë të jetë ajo që është. Parimi i qeverisjes është ndjesia që duhet t'i nxisë njerëzit brenda një lloji të qeverisjes, me qëllim që kjo të funksionojë harmonishëm. Në këtë mënyrë, virtyti është parimi i republikës, çfarë nuk do të thotë që njerëzit e republikës janë të virtytshëm, por që do të duhej të ishin dhe që republikat janë të mbara vetëm nëse qytetarët e saj janë të virtytshëm.<sup>2</sup>

Natyra e çdo qeverisjeje është përcaktuar në bazë të numrit të mbajtësve të sovranitetit. Monteskjë shkruan: "Unë marr me mend tre përkufizime ose, më saktë, tre fakte: një, që qeverisja republikane është ajo qeverisje në të cilën populli në tërësi, ose vetëm një pjesë e tij, vishet me pushtetin sovran; qeverisja monarkike është ajo qeverisje në të cilën qeveris një individ i vetëm, por nëpërmjet ligjeve të përcaktuara dhe të vendosura; ndërkaq, në qeverisjen despotike një individ i vetëm qeveris gjithçka sipas vullnetit dhe trilleve të tij, pa ligj dhe pa rregull." (*Fryma e ligjeve*, lib. II, kap. 1, vep. e cit., vëll. II, f. 230). Dallimi midis *popullit në tërësi* dhe *vetëm një pjesë të tij*, i zbatuar te

qeverisja republikane, ka si qëllim të kujtojë të dy llojet e qeverisjes republikane: demokracinë dhe aristokracinë.

Por,, këto përkufizime tregojnë menjëherë se natyra e një qeverisjeje nuk varet vetëm nga numri i atyre që kanë pushtetin sovran, por edhe nga forma e ushtrimit të tij. Monarkia e despotizmi janë, që të dyja, regjime që kanë një mbajtës të vetëm të pushtetit sovran, por në rastin e regjimit monarkik, mbajtësi i vetëm sundon sipas rregullave të caktuara dhe të vendosura, kurse në despotizëm sundon pa ligj dhe pa rregulla. Kështu, kemi dy kritere ose, në zhargonin modern, dy të ndryshueshme për të saktësuar natyrën e çdo qeverisjeje. Nga njëra anë, kush e ka pushtetin sovran, nga ana tjetër, sipas cilave forma ushtrohet ky pushtet sovran?

Duhet shtuar dhe kriteri i tretë, ai i parimit të qeverisjes. Një lloj qeverisjeje nuk përkufizohet aq sa duhet nëpërmjet karakteristikës, pothuajse juridike, të mbajtjes së pushtetit sovran. Çdo lloj qeverisjeje e karakterizon edhe ndjesia, pa të cilën ajo nuk mund të zgjasë e të lulëzojë.

Pra, sipas Monteskjës ka tri ndjesi politike themelore që sigurojnë, secila prej tyre, qëndrueshmërinë e një lloji të qeverisjes. Republika varet nga virtyti, monarkia nga nderi dhe despotizmi nga frika.

Virtyti i republikës nuk është një virtyt moral, por një virtyt i mirëfilltë politik. Ai përbën respektin për ligjet dhe besnikërinë e individit ndaj bashkësisë.

Nderi është, siç e thotë Monteskjë, “një nder i gënjeshtërt, thënë në mënyrë filozofike”. Ai përbën respektin e detyrueshëm të secilit ndaj rangut të vet.<sup>3</sup>

Për sa i përket frikës, ajo nuk ka nevojë të përkufizohet. Ajo është një ndjesi elementare dhe, si të thuash, infrapolitike. Por, ajo është një ndjesi, me të cilën janë marrë të gjithë teoricienët e politikës, sepse shumë prej tyre, që nga Hobsi, e kanë konsideruar si ndjesinë më njerëzore, më rrënjësore, ajo prej së cilës fillon shpjegimi i vetë shtetit. Mirëpo, Monteskjë nuk është pesimist si Hobsi. Sipas tij, një regjim që mbështetet mbi frikën është në thelb i korruptuar dhe, pothuajse, në prag të asgjësimit politik. Shtetasit që binden vetëm nga frika, pothuajse nuk janë më njerëz.



Ky klasifikim i regjimeve është origjinal në krahasim me traditën klasike.

Monteskjé shqyrton, para së gjithash, demokracinë dhe aristokracinë, të cilat në klasifikimin e Aristotelit janë dy lloje të ndryshme, si dy forma të një regjimi të njëjtë të quajtur republikan, dhe e dallonte këtë regjim nga monarkia. Sipas Monteskjësë, Aristoteli nuk e ka njohur natyrën e vërtetë të monarkisë. Kjo shpjegohet lehtë, sepse monarkia, ashtu siç e kuptonte Monteskjé, ishte sendërtuar në mënyrë autentike vetëm në monarkitë evropiane.<sup>4</sup>

Ky origjinalitet shpjegohet me një arsye të thellë. Dallimi i llojeve të qeverisjes është te Monteskjé, në të njëjtën kohë, një dallim i organizimeve dhe i strukturave shoqërore. Aristoteli kishte bërë një teori të regjimeve, së cilës i kishte dhënë, në dukje, një vlerë të përgjithshme, por ai mbante parasysh qytetin grek si bazë shoqërore. Monarkia, aristokracia, demokracia përbënin të tri format e organizimit politik të qyteteve greke. Ishte e ligjshme të dalloheshin llojet e qeverisjes, sipas numrit të mbajtësve të pushtetit sovran. Por, ky lloj përimtimi kërkonte që këto tri regjime të ishin, mund të përdorim këtu një shprehje moderne, superstrukturë politike të njëfarë forme shoqërore.

Filozofia politike klasike nuk merrej shumë me marrëdhëniet ndërmjet llojeve të superstrukturës dhe bazave shoqërore. Ajo nuk e kishte formuluar qartë pyetjen për të mësuar deri në ç'masë mund të ndërtohet klasifikimi i regjimeve politike, pa përfshirë këtu organizimin e shoqërive. Kontributi vendimtar i Monteskjësë është, pikërisht, rimarrja e problemit në përgjithësi dhe kombinimi i përimtimit të regjimeve me atë të organizimeve shoqërore, në atë mënyrë që secila prej qeverisjeve të duket njëkohësisht si njëfarë shoqërie.

Raporti midis regjimit politik dhe shoqërisë përcaktohet, para së gjithash dhe në mënyrë të qartë, duke mbajtur parasysh përmasën e shoqërisë. Sipas Monteskjësë, secila prej këtyre tri qeverisjeve i përgjigjet njëfarë përmaseje të shoqërisë që mbahet parasysh.

Formulime ka plot:

“Është në natyrën e republikës që të ketë një territor të vogël; pa këtë kusht, ajo nuk mund të mbijetojë”. (Lib. VIII, kap. 16, vep. cit., vëll. II, f. 362).

“Një shtet monarkik duhet të ketë madhësi mesatare. Në rast se territori i tij do të ishte i vogël, ai do të krijonte një republikë. Në rast se do të kishte territor shumë të madh, dinjitarët e shtetit, vetvetiu ngrehalucë, duke mos qenë fare nën syrin e princit dhe duke pasur oborritin e tyre jashtë oborrit të tij, të siguruar, përveç kësaj, me ligje dhe doke kundër zbatimit të shpejtë të urdhrave, do të mund të tregoheshin të pabindur”. (Lib. VIII, kap. 17, vep. cit. vëll. II, f. 363).

“Një perandori e madhe nënkupton një pushtet despotik të përqendruar në personin e atij që qeveris.” (Lib. VIII, kap. 19, vep. cit., vëll. II, f. 365).

Po të donim t’i kthenim këto formulime në parime të një logjike të përpiktë, nuk do të duhej të përdornim, me sa duket, një gjuhë shkakësie, domethënë të pohojmë se, posaqë territori i një shteti tejkalon njëfarë përmase, despotizmi është i pashmangshëm, por më mirë të thoshim se ndërmjet vëllimit të shoqërisë dhe llojit të qeverisjes ka një përputhje të natyrshme. Përveç kësaj, kjo sigurisht shtron para shqyrtuesit një problem të vështirë: në qoftë se, duke u nisur nga një përmase, një shtet do të mund të ishte vetëm despotik, a do të ishte sociologu i detyruar të pranonte domosdoshmërinë e një regjimi, të cilin, nga pikëpamja humane e morale, e quante të keq? Veç në mos iu shmangte këtij rrjedhimi të papëlqyeshëm duke thënë se shtetet nuk duhet të kalojnë njëfarë përmase.

Sidoqoftë, nëpërmjet kësaj teorie të përmaseve, Monteskjë e lidh klasifikimin e regjimeve me atë që quhet morfologji shoqërore, ose vëllim i shoqërive, për të rimarrë shprehjen e Durkajmit.

Monteskjë e lidh klasifikimin e regjimeve edhe me përimtimin e shoqërive, duke u bazuar mbi (në) nocionin e parimit të qeverisjes, domethënë të ndjesisë së domosdoshme për funksionimin e një regjimi. Teoria e parimësisë çon haptazi te një teori e organizimit shoqëror.

Në qoftë virtyti, në regjimin republikan, dashuri për ligjet, përkushtim ndaj bashkësisë, patriotizëm, për të përdorur një shprehje moderne, ai çon, po ta shikojmë hollë-hollë, tek njëfarë kuptimi të

barazisë. Republika është një regjim, ku njerëzit jetojnë nga bashkësia dhe për bashkësinë, ku ata ndihen qytetarë, gjë që nënkupton se janë dhe ndihen të barabartë mes tyre.

Nga ana tjetër, parimi i monarkisë është nderi. Monteskjë krijon teorinë e saj në një mënyrë të tillë që, herë pas here, duket polemizuese dhe ironike.

“Në monarki, politika nxit për vepra të mëdha me sa më pak virtyt që të jetë e mundur. Ashtu sikurse ndodh me makinat më të përsosura, ku gjithçka kryhet me sa më pak lëvizje, forcë e mekanizma që të jetë e mundur, shteti mbijeton, pavarësisht nga dashuria për atdheun, nga dëshira për lavdinë e vërtetë, nga vetëmohimi, nga sakrifikimi i interesave më të shtrenjta vetjake dhe i të gjitha atyre virtyteve heroike që i hasim në lashtësi dhe për të cilat vetëm kemi dëgjuar të flitet”. (Lib. III, 5, vep. cit., f. 255).

“Qeverisja monarkike nënkupton, siç thamë, paritë, rangjet e madje fisnikërinë burimore. Nderi ka në natyrën e vet kërkesën për të bërë përzgjedhje dhe dallime. Ai e ka, pra, vetvetiu vendin në këtë qeverisje. Ambicia është e dëmshme në formën e qeverisjes republikane. Ajo ka efekte të mira në qeverisjen monarkike; ajo i jep jetë kësaj qeverisjeje dhe, për më tepër, ka të mirën që nuk është e rrezikshme, sepse mund të mposhtet kurdoherë”. (Lib. III, kap. 7, vep. cit. vëll. II, f. 257).

Ky përimtim nuk është plotësisht i ri. Qëkurse njerëzit kanë menduar për politikën, janë lëkundur ndërmjet dy tezave të skajshme. E para, një shtet shkon mbarë vetëm atëherë kur njerëzit e duan hapur të mirën e bashkësisë; e dyta, meqenëse është e pamundshme që njerëzit ta duan hapur të mirën e bashkësisë, regjim i mirë është ai në të cilin të metat e njerëzve ndihmojnë për të mirën e të gjithëve. Teoria e nderit e Monteskjësë është një formë e tezës së dytë, pa u mashtruar. E mira e bashkësisë sigurohet, në mos nga të metat e qytetarëve, të paktën nga cilësitë e dorës së dytë, madje nga qëndrimet, të cilat moralisht do të mund të qortoheshin.

Personalisht, unë mendoj që, në kapitujt e Monteskjësë mbi nderin, ka dy qëndrime ose dy qëllime zotëruese: ka një zhvlerësim relativ të nderit në krahasim me virtytin e vërtetë politik, me atë të të vjetërve dhe me atë të republikave; por, ka gjithashtu një vlerësim të nderit si

parim i marrëdhënieve shoqërore dhe si mbrojtje e shtetit kundër së keqes më të madhe, despotizmit.

Në të vërtetë, në qoftë se dy qeverisjet: republikane dhe monarkike dallojnë në thelb, sepse njëra bazohet mbi barazinë e tjetra mbi pabarazinë, sepse njëra mbështetet mbi virtytin politik të qytetarëve e tjetra mbi një substitut të virtytit, siç është nderi; këto dy regjime kanë, megjithatë, një tipar të përbashkët: janë të moderuara, askush nuk jep urdhra në mënyrë arbitrare dhe jashtë ligjeve. Përkundrazi, kur arrijmë te qeverisja e tretë, domethënë te qeverisja despotike, largohemi nga qeverisjet e moderuara. Në klasifikimin e tre qeverisjeve, Monteskjë kombinon një klasifikim dualist të qeverisjeve të moderuara dhe të qeverisjeve të pamoderuara. Republika dhe monarkia janë të moderuara, despotizmi nuk është.

Këtyre do t'u shtonim një lloj të tretë klasifikimi që do ta quaja, për t'iu përshtatur modës, dialektik. Republika bazohet mbi një organizim të barazisë së marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të bashkësisë. Monarkia bazohet kryesisht mbi dallimin dhe pabarazinë. Për sa i takon despotizmit, ai shënon kthimin tek barazia. Mirëpo, derisa barazia republikane është barazi nga virtyti dhe nga pjesëmarrja e të gjithëve në pushtetin sovran, barazia despotike është barazi nga frika, nga pamundësia dhe nga mospjesëmarrja në pushtetin sovran.

Me despotizmin Monteskjë paraqet, si të thuash, të keqen e plotë politike. Vërtet që despotizmi është mbase i pashmangshëm, kur shtetet bëhen tepër të mëdhenj, por njëkohësisht despotizmi është një regjim, në të cilin sundon një i vetëm, pa rregulla e pa ligje dhe ku, rrjedhimisht, mbretëron frika. Mund të thuhet që secili ka frikë nga të gjithë të tjerët sapo të vendoset despotizmi.

Shkurt, në mendimin politik të Monteskjësë, kundërshtia kryesore qëndron ndërmjet despotizmit, ku secili ka frikë prej secilit, dhe regjimeve të lira, ku asnjë qytetar s'ka frikë nga tjetri. Këtë siguri, që secilit i jep liria, Monteskjë e ka shprehur hapur dhe qartë në kapitujt kushtuar kushtetutës angleze në librin XI. Në despotizëm, pushteti absolut i atij që sundon përballë me një kufizim të vetëm, që është feja, megjithëse kjo mbrojtje nuk është e qëndrueshme.

Sigurisht që kjo sintezë nxit diskutim dhe kritikë.

Para së gjithash, mund të pyesim veten nëse despotizmi është model politik konkret, me po atë kuptim si republika ose monarkia. Monteskjë saktëson se modeli i republikës na është dhënë nga republikat antike dhe, në veçanti, nga Republika Romake, para pushtimeve të mëdha. Modele të monarkisë janë monarkitë evropiane, angleze e franceze, të kohës së tij. Për sa u përket modeleve të despotizmit, ato janë përfundimisht perandoritë, që ai i quan aziatike, me një amalgamë të Perandorisë Persiane dhe të Perandorisë Kineze, të Perandorisë Indiane dhe të Perandorisë Japoneze. Sigurisht që njohuritë e Monteskjësë mbi Azinë ishin fragmentare, pavarësisht se ai kishte një dokumentim që do t'ia kishte bërë të mundur të shprehte në mënyrë më të nuancuar kuptimin e tij për despotizmin aziatik.

Monteskjë është nisur nga interpretimi i historisë së Azisë, që ende nuk është zhdukur plotësisht dhe që është karakteristik për mendimin evropian: regjimet aziatike do të ishin kryesisht despotizma, që kishin zhdukur çdo strukturë politike, çdo institucion dhe çdo masë. Despotizmi aziatik, ashtu siç e ka parë Monteskjë, është shkretëtira e skllavërisë. Vetëm sovrani absolut është i plotfuqishëm, ai ia kalon, në u dashtë, pushtetin e tij një veziri të madh; por, cilatdo qofshin format e marrëdhënieve midis despotit dhe rrethit të tij, nuk ka klasë shoqërore të ekuilibruar, nuk ka rende e as ranje; as barasvlerë të virtytit antik, as barasvlerë të nderit evropian; frika sundon miliona njerëz tej përtej hapësirave shumë të mëdha, kur shteti mund të qëndrojë vetëm me kusht që një i vetëm të mund të bëjë gjithçka.

Pra, kjo teori e despotizmit aziatik mos është gjithashtu, dhe në mënyrë të veçantë, imazhi ideal i sëmundjes politike, evokimi i së cilës nuk bëhet pa një qëllim polemizues me monarkitë evropiane? Të mos e harrojmë fjalinë e famshme: "Të gjitha monarkitë do të treten në despotizëm, si lumenjtë në det". Ideja për despotizmin aziatik është mendimi i pashqitur për fundin e mundshëm të monarkive, kur këto humbasin respektin për rendet, për fisnikërinë, për shtresat e ndërmjetme pa të cilat pushteti absolut e arbitrar i një të vetmi humb çdo masë.

Teoria e qeverisjeve e Monteskjës rrezikon të shpjerë gjithashtu në një lloj fatalizmi kur ndërton përputhje midis përmasave të territorit dhe formës së qeverisjes.

Në *Frymën e ligjeve* ka një luhatje midis dy skajesh. Do të ishte e lehtë të përmendeshin shumë tekste, sipas të cilave do të ndërtohej një lloj hierarkie: republikën, që është regjimi më i mirë, do ta pasonte monarkia dhe së fundi despotizmi. Mirëpo, nga një anë tjetër, në qoftë se çdo regjim është emërtuar në mënyrë të pamatur, sipas njëfarë përmase të trupit shoqëror, ne do të jemi jo para një hierarkie vlerash, por para një determinizmi të pashmangshëm.

Ekziston më në fund një kritikë e fundit ose pasiguri, që përqendrohet tek thelbësorja dhe ka të bëjë me lidhjen ndërmjet regjimeve politike dhe llojeve të shoqërisë.

Kjo lidhje mund të mendohet, në të vërtetë, në mënyrë të ndryshme. Sociologu ose filozofi mund të thotë se një regjim politik përkufizohet në mënyrë të mjaftueshme sipas një kriteri të vetëm, për shembull, sipas numrit të atyre që kanë në duar sovranitetin, dhe të themelohet kështu një klasifikim regjimesh politike që kanë një kuptim tej historik. I tillë ishte konceptimi që ekzistonte në mënyrë të vetëkuptueshme në filozofinë politike klasike që, kur bënte një teori të regjimeve, parakuptonte, si të thuash, vlefshmërinë jashtëkohore të formave politike përveç organizimit shoqëror.

Mirëpo, është e mundur gjithashtu që, siç bën pak a shumë në mënyrë të qartë Monteskjë, të kombinohen në mënyrë të ngushtë regjimi politik dhe lloji shoqëror. Me këtë rast, dalim tek ajo që Maks Veberi do t'i quante tre lloje ideale: ai i qytetit antik, shtet përmasash të vogla i qeverisur sipas rregullave të republikës, demokraci ose aristokraci; ai i monarkisë evropiane, thelbi i të cilit është dallimi i rendeve, monarkia ligjore dhe e moderuar; dhe, së fundi, ai i despotizmit aziatik, shtet përmasash të skajshme, pushtet i plotë i një të vetmi, në të cilin feja është i vetmi kufizim i arbitraritetit të sovranit; barazia rivendoset, por të gjithë janë të pafuqishëm.

Monteskjë parapëlqeu konceptin e dytë të raportit ndërmjet regjimit politik dhe llojit të shoqërisë. Por, me këtë rast, shtrohet pyetja: në ç'masë regjimet politike mund të ndahen nga entitetet historike, në të cilat janë sendërtuar?

Sidoqoftë, duket e vërtetë, megjithëkëtë, se ideja thelbësore është lidhja e krijuar ndërmjet formës së qeverisjes, llojit të regjimit, nga njëra anë, stilit të marrëdhënieve ndërpersonale, nga ana tjetër. Në fakt, për Monteskjënë ka më pak rëndësi vendimtare kur pushteti sovran është në duar të më shumë a të një personi të vetëm, sesa kur ai ushtrohet sipas ligjeve dhe masës ose, në të kundërtën, arbitrarisht dhe me dhunë. Jeta shoqërore dallohet sipas formës së ushtrimit të qeverisjes. Një mendim i tillë mbetet i rëndësishëm në një sociologji regjimesh politike.

Përveç kësaj, çfarëdo që të jetë interpretimi i marrëdhënieve ndërmjet klasifikimit të regjimeve politike dhe klasifikimit të llojeve të shoqërisë, Monteskjë ka meritën e pamohueshme që e shtroi qartë problemin. Dyshoj ta ketë zgjidhur përfundimisht, por a ka arritur njeri ta bëjë këtë?

\*\*\*\*

Dallimi ndërmjet qeverisjes së moderuar dhe qeverisjes jo të moderuar është me sa duket qendror në mendimin e Monteskjës. Ky dallim mundëson që, shqyrtimet mbi Anglinë, të cilat gjenden në librin XI, të përfshihen në teorinë e llojeve të qeverisjes të librave të parë.

Nga kjo pikëpamje, teksti thelbësor është kapitulli i VI i librit XI, në të cilin Monteskjë studion kushtetutën e Anglisë. Ky kapitull ka bërë një jehonë të tillë, saqë shumë konstitucionalistë anglezë i kanë interpretuar institucionet e vendit të tyre sipas asaj që ka thënë Monteskjë për to. Prestigji i gjenit ka qenë i atillë, saqë anglezët kanë menduar se kuptoheshin midis tyre duke lexuar *Frymën e ligjeve*.<sup>5</sup>

Monteskjë ka zbuluar tek Anglia një shtet që ka si qëllim të vetëm, nga njëra anë lirinë politike, nga ana tjetër faktin dhe idenë për përfaqësimin politik. "Ndonëse të gjitha shtetet në përgjithësi kanë si qëllim të njëjtë, atë të ruajtjes së tyre, çdo shtet ka, megjithatë, një të

---

\* Kuptohet vetvetiu që unë këtu nuk do të studioj hollësisht as ç' ishte kushtetuta angleze në shek. XVIII, as ç'ka menduar Monteskjë për të, më së fundi, as ç'është bërë me të në shek. XX. Dua vetëm të tregoj se si idetë kryesore të Monteskjës mbi Anglinë përfshihen në konceptimin e tij të përgjithshëm për politikën.

veçantë, – shkruan Monteskjë. Zgjerimi ishte qëllimi i Romës; lufta - ai i Lacedemonisë; feja - ai i ligjeve judaike; tregtia - ai i Marsejës... Në botë ka edhe një komb, i cili ka lirinë politike si qëllim të drejtpërdrejtë të kushtetutës së vet,”. (*Fryma e ligjeve*, lib. XI, kap. 5, vep. cit., vëll. VII, f. 396). Për sa i përket përfaqësimit, mendimi për të nuk figuronte në rend të parë në teorinë e republikës. Republikat për të cilat mendon Monteskjë, janë republikat e lashta, ku ekzistonte një kuvend i popullit dhe jo një kuvend i zgjedhur nga populli dhe i përbërë nga përfaqësuesit e popullit. Vetëm në Angli ka mundur ta shohë të realizuar plotësisht institucionin e përfaqësimit.

Kjo qeverisje, e cila ka si objektiv lirinë dhe në të cilën populli është i përfaqësuar nga kuvendet, ka si karakteristikë madhore atë që është quajtur ndarje e pushteteve, doktrinë kjo që ka ruajtur aktualitetin dhe rreth së cilës janë bërë spekulime të pakufishme.

Monteskjë konstaton se në Angli një monark ka në dorë pushtetin ekzekutiv. Për shkak se ky kërkon shpejtësi vendimi e veprimi, e mira është që ta ketë në dorë një i vetëm. Pushteti ligjvënës është përfaqësuar nga dy kuvende: Dhoma e Lordëve, e cila përfaqëson fisnikërinë, dhe Dhoma e Komuneve, e cila përfaqëson popullin.

Këto dy pushtete, ekzekutivi e ligjvënësi, janë në duar të personave ose trupave të ndryshëm. Monteskjë përshkruan bashkëpunimin e këtyre organeve, po aq sa përimiton ndarjen e tyre. Ai tregon, në të vërtetë, çka mundet dhe duhet të bëjë secili prej këtyre pushteteve në krahasim me tjetrin.

Ka edhe një pushtet të tretë, pushteti gjyqësor. Por, Monteskjë saktëson se “pushteti gjyqësor, aq i tmerrshëm për njerëzit, bëhet, si të thuash, i padukshëm dhe i paqenë, për shkak se nuk i bashkëngjitet as ndonjë shtrese të caktuar, as ndonjë profesioni të caktuar.” (“*Fryma e ligjeve*”, lib. XI, kap. 6, vep. cit., vëll. II, f. 398). Kjo gjë siç duket tregon se pushteti juridik, që është kryesisht interpretues i ligjeve, duhet të ketë sa më pak të jetë e mundur, iniciativë e personalitet. Ky nuk është pushtet i personave, por i ligjeve, “njeriu i ndruhet gjykatës dhe jo gjykatësve” (Po aty.).

Pushteti ligjvënës bashkëpunon me pushtetin ekzekutiv; ai duhet të shqyrtojë në çfarë mase ky i fundit ka zbatuar ligjet ashtu si duhet. Për sa i përket pushtetit “ekzekutiv”, ky nuk mund të diskutojë për



punët e pushtetit ligjvënës, por ai duhet të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me pushtetin ligjvënës nëpërmjet asaj, që ai e quan *mundësi e tij për të penguar*. Monteskjë shton gjithashtu se buxheti duhet të votohet çdo vit. “Në qoftë se pushteti ligjvënës vendos për mbledhjen e të ardhurave shtetërore jo vit më vit, por përgjithmonë, ai rrezikon të humbasë lirinë e tij, sepse pushteti ekzekutiv nuk do të varej më prej tij.” (Po aty, f. 405). Votimi vjetor i buxhetit është si një kusht i lirisë.

Për arsye se janë shtruar këto të dhëna të përgjithshme, interpretuesit kanë vënë theksin në faktin se pushteti ekzekutiv e pushteti ligjvënës dallohen; ca të tjerë në faktin se duhej të kishte bashkëpunim të përhershëm ndërmjet tyre.

Teksti i Monteskjësë është përqasur me tekstet me të njëjtin subjekt të Lokut; disa tuhafësi të parashtrësës së Monteskjësë shpjegohen nëse i drejtohem teksti të Lokut.<sup>6</sup> Në krye të kapitullit të gjashtë ka veçanërisht dy përkufizime të pushtetit ekzekutiv. Herën e parë, ky është përkufizuar si pushtet ekzekutiv, që merr vendime për “çështjet që varen prej së drejtës publike”. (Po aty, f. 396), gjë që duket se e përfshin brenda politikës së jashtme. Pak më poshtë, ai është përkufizuar si pushtet, që “zbaton vendimet shtetërore” (Po aty, f. 397), gjë që i jep një shtrirje krejt tjetër. Në njërin rast, Monteskjë ndjek tekstin e Lokut. Por, ndërmjet Lokut e Monteskjësë ka një dallim rrënjësor të qëllimit. Qëllimi i Lokut është të kufizojë pushtetin mbretëror, të tregojë se nëse monarku kalon disa kufij ose nuk kryen disa detyrime, populli, burim i vërtetë i sovranitetit, ka të drejtë të reagojë. Përkundrazi, ideja kryesore e Monteskjësë nuk është ndarja e pushteteve, në kuptimin juridik të fjalës, por ajo që do të mund të quhej *baraspehë e forcave shoqërore*, kusht i lirisë politike.

Në tërë përimtimin e kushtetutës angleze, Monteskjë nënkupton një fisnikëri dhe dy dhoma, njëra prej të cilave përfaqëson popullin, ndërsa tjetra aristokracinë. Ai ngul këmbë që fisnikët të gjykohen vetëm nga njerëz të sërës së tyre. Në të vërtetë, “të mëdhenjtë gjithmonë shihen me smirë dhe, po të gjykoreshin prej popullit, do të mund të viheshin në rrezik dhe nuk do ta gëzonin privilegjin për t’u gjykuar nga njerëz të sërës së tyre, gjë që e gëzon edhe qytetari më i parëndësishëm në një shtet të lirë. Prandaj, fisnikët duhet të hidhen jo

para gjyqeve të zakonshme të kombit, por para asaj pjese të trupit ligjvënës që përbëhet nga fisnikët.” (po aty, f. 404). Me fjalë të tjera, Monteskjë, duke përimtuar kushtetutën angleze, synon të gjejë diferencimin shoqëror, dallimin e klasave dhe të rendeve, në përputhje me thelbin e monarkisë, sipas përkufizimit të tij dhe të domosdoshmërisë për modelimin e pushtetit.

Një shtet është i lirë do të thosha me kënaqësi, duke komentuar Monteskjënë, atëherë kur pushteti atje e ndalon pushtetin. Për ta arsyetuar këtë interpretim, një përshtypje të veçantë bën libri XI, në të cilin, pasi e ka përfunduar shqyrtimin e kushtetutës së Anglisë, i kthehet prapë Romës dhe përimton në tërësi historinë romake me gjuhën e marrëdhënieve ndërmjet plebenjve dhe patricëve. Ajo që e intereson, është rivaliteti midis klasave. Kjo garë shoqërore është kusht i regjimit të moderuar, sepse klasat e ndryshme janë në gjendje të krijojnë baraspeshë midis tyre.

Për sa i përket vetë kushtetutës, është më se e vërtetë se Monteskjë tregon deri në hollësi, sesi secili prej pushteteve ka këtë ose atë të drejtë dhe sesi pushtetet e ndryshme duhet të bashkëpunojnë. Por, ky formësim kushtetues s’është asgjë më shumë se shprehje e një shteti të lirë, ose, do të thosha me dëshirë, e një shoqërie të lirë, në të cilën asnjë pushtet nuk mund të shtrihet pa kufij, sepse ndalohet nga pushtete të tjera.

Një tekst i *Përsiatje mbi shkaqet e madhështisë dhe të rënies së romakëve*, e përmbledh shumë mirë këtë temë qendrore të Monteskjësë: “Në shumicën e rasteve, sa herë që do të vini re se të gjithë janë të qetë në shtetin që e quan veten republikë, mund të jeni të sigurt se aty nuk ka liri. Ajo që e quajmë bashkim në një grup politik, është diçka tepër e dykuptimshme. Bashkimi i vërtetë është bashkim në harmoni, i cili bën që të gjitha palët, sado të kundërta që të na duken, të ndihmojnë për arritjen e së mirës së përgjithshme të shoqërisë, ashtu si disonancat në muzikë që ndihmojnë për të arritur harmoninë e përgjithshme. Brenda një shteti, që në shfaqje të duket i trazuar, mund të ketë bashkim, domethënë harmoni prej nga rezulton lumturia, e cila është e vetmja paqe e vërtetë. Pikërisht kështu ka ngjasim me pjesët e gjithësisë, përjetësisht të lidhura me veprimin e disave dhe kundërveprimin e ca të tjerave.” (kap. 9, vep. cit., vëll. II, f. 119).

Kuptimi i konsensusit shoqëror është ai i një baraspeshe forcash ose paqje të vendosur nëpërmjet veprimit dhe kundërveprimit midis grupeve shoqërore.<sup>7</sup>

Nëse ky përimtim është i saktë, teoria e kushtetutës angleze është në qendër të sociologjisë politike të Monteskjësë, jo për shkak se ajo është model për të gjitha vendet, por për shkak se ajo lejon për të gjetur, në mekanizmin kushtetutës të një monarkie, bazat e një shteti të moderuar e të lirë, në saje të baraspeshës midis klasave shoqërore, në saje të baraspeshës së pushteteve politike.

Por, kjo kushtetutë, model i lirisë, është aristokratike dhe, për këtë arsye, janë parashtruar interpretime të ndryshme.

Interpretimi i parë, i cili për një kohë të gjatë ka qenë ai i juristëve dhe që me gjasë ka qenë edhe ai i konstitucionalistëve francezë të vitit 1958, është teori e ndarjes, sipas kuptimit juridik, të pushteteve brenda regjimit republikan. Presidenti i republikës dhe kryeministri, nga njëra anë, parlamenti, nga ana tjetër, kanë të drejta të përkufizuara mirë, baraspesha e të cilave është marrë nga mënyra ose tradita e Monteskjësë, pikërisht nga rregullimi i saktë i marrëdhënieve midis organeve të ndryshme.<sup>8</sup>

Interpretimi i dytë, ngul këmbë në baraspeshën e forcave shoqërore, ashtu siç po e bëj unë, dhe vë theksin gjithashtu mbi karakterin aristokratik të pikëpamjes së Monteskjësë. Ky mendim për baraspeshën e forcave shoqërore nënkupton fisnikërinë, ai shërben si arsyetim për forcat e ndërmjetme të shek. XVIII, në çastin kur këto po zhdukeshin. Në këtë pikëpamje, Monteskjë është përfaqësues i aristokracisë, i cili reagon kundër pushtetit monarkik në emër të klasës së vet, e cila është një klasë e dënuar. Ai ngrihet, si viktimë e dredhisë së historisë, kundër mbretit, sepse deshi të punonte për fisnikërinë, por polemika e tij do t'i sillte dobi vetëm çështjes së popullit.<sup>9</sup>

Unë vetë mendoj se ka edhe një interpretim të tretë, i cili rimerr të dytin, por e tejkalon atë, në kuptimin e *aufheben-it* të Hegelit, domethënë shkon më tej gjithë duke ruajtur pjesën e së vërtetës.

Është e vërtetë që Monteskjë e përfytyronte baraspeshën e forcave shoqërore, si kusht i lirisë, vetëm sipas modelit të një shoqërie aristokratike. Ai mendonte se qeverisjet e mira ishin të moderuara,

dhe se ato mund të ishin të moderuara vetëm atëherë kur pushteti ndalonte pushtetin ose, të paktën, kur asnjë qytetar nuk ia kishte frikën asnjë qytetari tjetër. Fisnikët mund ta ndjenin veten të sigurt, vetëm nëse të drejtat e tyre garantoreshin nga vetë organizimi politik. Kuptimi shoqëror i baraspeshës, që parashtrohet në “Frymën e ligjeve”, është i lidhur me një shoqëri aristokratike dhe me konfliktin e kohës së tij, i cili ka të bëjë me kushtetutën e monarkisë franceze; Monteskjë i përket krahut të aristokracisë e jo atij të mbretit apo të popullit.

Mirëpo, mbetet të shohim se mos mendimi që krijonte Monteskjë për kushtet e lirisë dhe të modelimit ngelet i vlefshëm përtej modelit aristokratik që kishte në mendje. Vetë Monteskjë do të kishte thënë se mund të përftohet, në të vërtetë, një evolucion shoqëror, nëpërmjet të cilit dallimi i rendeve e i rangjeve synon të zhduket. Mirëpo, a mund të merret me mend një shoqëri pa rende e rangje, një shtet pa pluralitet pushtetesh, i cili do të ishte njëkohësisht i moderuar dhe në të cilin qytetarët do të ishin të lirë?

Që Monteskjë, i cili deshi të punonte për fisnikërinë dhe kundër mbretit, të ketë punuar për lëvizjen popullore e demokratike, mund ta mbrojmë ose ta kundërshtojmë. Mirëpo, në qoftë se i drejtohem historisë, ngjarjet e kanë arsyetuar në një masë të gjerë doktrinën e tij. Ato kanë treguar se një regjim demokratik, në të cilin fuqia sovrane u takon të gjithëve, nuk është, megjithatë, qeverisje e moderuar dhe e lirë. Monteskjë ka plotësisht të drejtë, më duket, që ruan dallimin rrënjësor midis pushtetit të popullit dhe lirisë së qytetarëve. Mund të ndodhë që, edhe pse populli është sovran, siguria e qytetarëve dhe moderimi të zhduken gjatë ushtrimit të pushtetit.

Përtej formulimit aristokratik të doktrinës së tij për baraspeshën e forcave shoqërore dhe të bashkëpunimit të pushteteve politike,<sup>10</sup> Monteskjë ka shtruar parimin, sipas të cilit kushti i respektimit të ligjeve dhe të sigurisë së qytetarëve është që asnjë pushtet të mos jetë i pakufizuar. E tillë është tema qendrore e sociologjisë së tij politike.

## ***Nga teoria politike te sociologjia***

Këto përimtime të sociologjisë politike të Monteskjës lejojnë të shtrohen problemet kryesore të sociologjisë së tij të përgjithshme.

I pari ka të bëjë me përfshirjen e sociologjisë politike në sociologjinë e përgjithshme shoqërore. Si të kalojë lloji i qeverisjes nga forma e privilegjuar në kuptimin e shoqërisë në tërësi? Kjo pyetje mund të krahasohet pikë për pikë me atë që shtron organizimi ekonomik, që ka të bëjë me marksizmin, kur duam të kalojmë nga forma e privilegjuar në konceptin e tërësisë.

Problemi i dytë është ai i lidhjes ndërmjet faktit dhe vlerës, ndërmjet kuptimit të institucioneve dhe përcaktimit të regjimit të dëshirueshëm ose të mirë. Me të vërtetë, si është e mundur që disa institucione të paraqiten njëkohësisht si të përcaktuara, domethënë që i imponohen vullnetit të njerëzve, dhe të jepen gjykime politike për këto institucione? A është e mundur që një sociolog ta quajë një regjim, që në disa raste mendohet të jetë i pashmangshëm, të kundërt me natyrën njerëzore?

Problemi i tretë është ai marrëdhënieve ndërmjet universalizmit racional dhe veçantive historike.

“Despotizmi është - thotë Monteskjë - në kundërshtim me natyrën njerëzore”. Por, ç’është natyra njerëzore? A është ajo natyra e të gjithëve, në të gjitha klimat dhe në të gjitha epokat? Deri ku arrijnë karakteret e njeriut si njeri dhe si mund t’i kombinojmë natyrën e njeriut si njeri me miratimin e diversitetit të pakufishëm të dokeve, të zakoneve dhe të institucioneve?

Vetë përgjigja e problemit të parë përmban tri etapa ose tri momente të përimtimit. Cilat janë shkaqet e jashtme që nuk kanë të bëjnë me regjimin politik që mban parasysh Monteskjë? Cili është karakteri i marrëdhënieve që ndërton ai midis shkaqeve dhe fenomeneve që duhen shpjeguar? A ka në *Frymën e ligjeve* një interpretim sintetik të shoqërisë së konsideruar si një tërësi, apo ka thjesht një numërim shkaqesh dhe një puqje marrëdhëniesh të ndryshme ndërmjet aksh përcaktuesi dhe aksh të përcaktuari, pa qenë e mundur të thuhet se asnjëri prej këtyre përcaktuesve nuk është vendimtar?

Numërimi i shkaqeve nuk paraqet, në dukje, asnjë karakter sistematik.

Monteskjë studion, së pari, atë që ne e quajmë ndikim i mjedisit gjeografik, i cili nën ndahet dysh: klima dhe trualli. Kur shqyrton truallin, ai kërkon se si, sipas natyrës së truallit, njerëzit kanë kultivuar tokën dhe ndarë pasurinë.

Pas ndikimit të mjedisit gjeografik, në librin XIX, ai kalon në përimtimin e frymës së përgjithshme të një kombi, term mjaft i dykuptimshëm në shikim të parë, sepse nuk dihet mirë nëse bëhet fjalë për një përcaktues, rezultat i gjithë të tjerëve, apo nëse bëhet fjalë për një përcaktues të veçantë.

Në vijim, Monteskjë nuk shqyrton më shkaqet fizike, por shkaqet shoqërore, në mesin e të cilave: tregtinë dhe paranë. Pra mund të thuhet se ai flet kryesisht për aspektin ekonomik të jetës kolektive, në qoftë se nuk do të kishte lënë pas dore pothuajse një element, i cili për ne ka rëndësi të madhe në përparimin e ekonomisë, pra mjetet e prodhimit, për të përdorur një term marksist, ose veglat e mjetet teknike që përdorin njerëzit. Në thelb, për Monteskjën, ekonomia është ose regjimi i pronës, në veçanti i tokës, ose tregtia, këmbimet, lidhjet ndërmjet bashkësive ose, më në fund, paraaja e cila për pikëpamjen e tij është një aspekt thelbësor i marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, brendapërbrenda bashkësive ose ndërmjet bashkësive. Ekonomia në thelb është ashtu siç e sheh ai, bujqësi e tregti. Jo se nuk e njeh fare atë që ai e quan zëjtari, fillimin e asaj që ne e quajmë industri, por qytetet që i sundon halli ekonomik janë, për pikëpamjen e tij, qytete tregtare ose tregjesh: Athina, Venediku e Gjenova. Me fjalë të tjera, antiteza kryesore qëndron: midis bashkësive, përkufizimi zotërues i të cilave është veprimtaria ushtarake dhe bashkësive, preokupimi zotërues i të cilave është tregtia. Ky nocion ishte tradicional në filozofinë politike paramoderne. Origjinaliteti i shoqërive moderne lidhet me industrinë e nuk shfaqet në filozofinë politike klasike dhe, nga kjo pikëpamje, Monteskjë i përket kësaj tradite. Nga kjo pikëpamje mund të thuhet madje se ai u paraprin enciklopedistëve. Ai nuk i kishte kuptuar plotësisht rrjedhimet e zbulimeve teknike në transformimin e mënyrave të punës dhe të gjithë shoqërisë.

Pas tregtisë e parasë pason studimi i numrit të banorëve. Problemi demografik mund të shtrohet historikisht në dy mënyra. Nganjëherë duhet luftuar kundër shpopullimit që, për mendimin e Monteskjësë, është rasti më i shpeshtë, sepse, po sipas tij, ajo që kërcënon shumicën e shoqërive është mungesa e njerëzve. Mirëpo, ai njuh edhe sfidën e kundërt, atë të luftës kundër një zhvillimi të popullsisë përtej pasurive të lira.

Së fundi, ai shqyrton rolin e fesë, që është konsideruar si një nga ndikimet më të efektshme në organizimin e jetës kolektive.

Përfundimisht, Monteskjë shqyrton hollësisht një numër shkaqesh. Dallimi që duket se zotëron në mendimin e tij, është ai ndërmjet shkaqeve fizike dhe shkaqeve morale. Klima dhe natyra e trojeve bëjnë pjesë në shkaqet fizike, ndërsa fryma e përgjithshme e një kombi ose feja, u përkasin shkaqeve morale. Për sa i përket tregtisë dhe numrit të banorëve, ai do të kishte mundur të krijonte me lehtësi një kategori tjetër, atë të karakteristikave të jetës kolektive, të cilat veprojnë mbi aspektet e tjera të vetë kësaj jete kolektive. Por, Monteskjë nuk ka bërë teori sistematike të shkaqeve të ndryshme.

Do të mjaftonte, megjithatë, të ndryshohej rendi për të pasur një numërim të kënaqshëm. Duke filluar nga mjedisi gjeografik, me dy nocionet e elaboruara më saktësisht, të klimës dhe të natyrës së truallit, do të kalohej në numrin e banorëve, sepse është më e logjikshme të shkohet nga mjedisi fizik, i cili kufizon vëllimin e shoqërisë, tek numri i banorëve. Prej këndeje do të arrihej tek shkaqet e mirëfillta shoqërore, prej të cilave Monteskjë ka shquar, megjithatë, dy shkaqe kryesore: në njërën anë, tërësinë e besimeve, që ai i quan fe (do të ishte lehtë të zgjerohej kuptimi) dhe, në anën tjetër, organizimin e punës dhe të këmbimeve. Atëherë do të dilej atje ku në të vërtetë ka dalë sociologjia e Monteskjësë: te koncepti i frymës së përgjithshme të një kombi.

Për sa u përket të përcaktuarve, domethënë atë që Monteskjë kërkon ta shpjegojë me anë të shkaqeve, të cilat i shqyrton një pas një, më duket se ai ka kryesisht tri nocione, atë të ligjeve, të dokeve dhe të shprehive, të cilat i përkufizon me saktësi. “Doket dhe shprehitë janë zakone, të cilat nuk janë vendosur me ligje, sepse ose nuk kanë mundur, ose nuk kanë dashur t’i vendosin. Ligjet dhe doket kanë

dallim midis tyre, sepse ligjet rregullojnë më shumë veprimin e qytetarit, ndërsa doket rregullojnë më shumë veprimet e njeriut. Dokat dhe shprehitë kanë dallim midis tyre, sepse të parat kanë të bëjnë më shumë me sjelljen e botës së brendshme të njeriut, ndërsa të dytat me atë të jashtme." (*Fryma e ligjeve*, lib. XIX, kap. 16, vep. cit., vëll. II, f. 566).

Dallimi i parë ndërmjet ligjeve dhe dokeve i përgjigjet dallimit që bëjnë sociologët ndërmjet asaj që dekretohet nga shteti dhe asaj që imponohet nga shoqëria. Në njërin rast ka urdhra të formuluar shprehimisht, të sanksionuar nga vetë shteti, në rastin tjetër, urdhra pozitivë ose negativë, rregulla ose ndalime, që u imponohen anëtarëve të një bashkësie, pa e bërë të detyrueshëm me ligj respektimin e tyre dhe, në rast shkeljeje, pa sanksione të parapara legalisht.

Dallimi midis dokeve dhe shprehive lidhet me dallimin e urdhrave të botës së brendshme dhe të mënyrave të veprimit tërësisht të jashtme, të diktuar nga bashkësia.

Monteskjë shquan si më kryesore tre lloje kryesore të ligjeve: ligjet civile, që kanë të bëjnë me organizimin e jetës familjare; ligjet penale, për të cilat ai, si të gjithë bashkëkohësit e tij, tregon shumë interesim;<sup>11</sup> ligjet kushtetuese të regjimit politik.

Për të kuptuar lidhjet që ka vënë Monteskjë ndërmjet shkaqeve dhe institucioneve, do të marr shembullin e librave që trajtojnë mjedisin gjeografik. Pikërisht në këto libra të famshëm del në pah, në mënyrën më të qartë, karakteri i përimitimit të Monteskjësë.

Në mjedisin gjeografik, ai shqyrton kryesisht klimën dhe truallin, por përpunimi kuptimor është përfundimisht mjaft i varfër. Sa për klimën, dallimi përmbledhet pothuajse në dallimin e ftohtë - e nxehtë, e moderuar - e skajshme. S'është nevoja të thuhet se gjeografët modernë përdorin nocione shumë më të sakta dhe shumëfishojnë dallimet ndërmjet llojeve të ndryshme të klimës. Sa për të truallin, Monteskjë shqyrton sidomos pjellshmërinë ose shterpësinë, së dyti relievin dhe shpërndarjen e tij në një kontinent të caktuar. Në të gjitha këto pika, ai nuk është shumë origjinal. Shumë prej ideve i ka marrë nga një mjek anglez, Arbutnot.<sup>12</sup> Por mua më intereson natyra logjike e marrëdhënieve shkakësore që ka formuluar.



Në shumë raste, Monteskjë e shpjegon drejtpërsëdrejti temperamentin e njerëzve, ndjeshmërinë e tyre, mënyrën e qenies së tyre në varësi të klimës. Kështu: “Në vendet e ftohta, ndjeshmëria e njeriut ndaj kënaqësive është e vogël; në vendet me temperaturë të mesme, ajo është më e madhe; në vendet e nxehta, ajo është e skajshme. Ashtu siç dallohen klimat me anë të shkallëve të gjerësisë gjeografike, ato do të mund të dalloheshin, si të thuash, edhe me anën të shkallëve të ndjeshmërisë. Kam parë operat e Anglisë dhe të Italisë: janë po ato pjesë dhe po ata aktorë; por e njëjta muzikë shkakton efekte aq të ndryshme në të dy kombet, njëri është aq i qetë, ndërsa tjetri aq i pasionuar, sa që s’ta pret mendja.” (*Fryma e ligjeve*, lib. XIV, kap. 2, vep. cit., vëll. II, f. 476).

Sociologjia do të ishte e lehtë po të ishin të vërteta parashtrimet e këtij lloji. Monteskjë duket mendon se një mjedis fizik përcakton drejtpërsëdrejti një mënyrë të qenies fiziologjike, nervore, psikologjike të njeriut.

Por, shpjegimet e tjera janë shumë më të ndërlikuara, si ato të famshmet që kanë të bëjnë me skllavërinë. Në librin XV, që ka si titull “Si lidhen ligjet e skllavërisë civile me llojin e klimës”, lexojmë:

“Ka vende ku nxehtësia tendos nervat e trupit dhe dobëson aq shumë guximin, sa që njerëzit mund të detyrohen të punojnë vetëm nga frika e ndëshkimit, skllavëria atje lëndon pra, më pak arsyen. Dhe duke qenë edhe skllavopronari po aq i frikësuar prej princit të vet sa është skllavi prej tij, skllavëria civile shoqërohet atje edhe nga skllavëria politike”. (Kap. 7, vep. cit., vëll. II, f. 495).

Një tekst i kësaj natyre nxjerr në pah aspekte të ndryshme të qëndrimit të Monteskjësë. Ka më parë një shpjegim të thjeshtë, pothuajse thjeshtësues, për lidhjen ndërmjet klimës dhe robërisë. Por, po në këtë copë teksti gjendet formulimi: “pra skllavëria atje lëndon më pak arsyen”, çka nënkupton se skllavëria si e tillë lëndon arsyen dhe përmban në mënyrë të vetëkuptueshme një referencë të përgjithshme të natyrës njerëzore. Në një copë të tillë teksti janë të puqura të dy aspektet e interpretimit, nga njëra anë interpretimi determinist i institucioneve si fakte, nga ana tjetër gjykimi i dhënë për këto institucione në emër të vlerave botërisht të vlefshme. Përputhshmëria e këtyre dy mënyrave të mendimit arrihet nëpërmjet

formulimit “atje lëndon më pak arsyen”. Pasi pohon se skllavëria, si e tillë, është në kundërshtim me thelbin e natyrës njerëzore, Monteskjë e arsyeton realitetin e skllavërisë me ndikimin e klimës. Por, një parashtrim i tillë është logjikisht i pranueshëm vetëm në masën në të cilën klima ndikon në një institucion apo e favorizon, pa e bërë këtë të fundit të domosdoshëm. Sepse, po të kishte lidhje të domosdoshme të shkakut me efektin, do të kishte patjetër kundërshtim ndërmjet dënimit moral dhe determinizmit shkencor të provuar.

Ky interpretim është vërtetuar në kapitullin tjetër. Nëpërmjet këtyre rreshtave tipikë të mendimit të tij, Monteskjë nxjerr atje si përfundim:

“Nuk di nëse është mendja apo zemra që më dikton ta shkruaj këtë artikull. Mbase nuk ka klimë mbi tokë, ku njerëzit e lirë nuk do të mund të nxiteshin për punuar. Meqenëse ligjet ishin hartuar keq, edhe njerëzit janë bërë përtacë. Dhe, pikërisht për shkak se këta njerëz ishin përtacë, kanë rënë në skllavëri”. (Lib. XV, kap. 8, f. 497). Në dukje, teksti i fundit mohon tekstin e mësipërm, i cili dukej se e nxirrte skllavërinë si rrjedhim të klimës, ndërsa këtu ajo është rrjedhim i ligjeve të këqija, meqenëse fjala e mësipërme lë të kuptohet se askund klima s’është e atillë që robërinë ta ketë bërë të domosdoshme. Në fakt Monteskjë ngatërrohet, siç ngatërrohen të gjithë sociologët kur ndeshen me fenomene të kësaj natyre. Nëse i shkojnë deri në fund shpjegimit shkakësor dhe zbulojnë se institucioni që i neverit ka qenë i pashmangshëm, duhet t’i pranojnë të gjitha. Kjo dhe mund të kuptohet nëse është fjala për institucionet e shekujve të kaluar, të shkuara e të harruara njëherë e mirë, dhe s’është nevoja të pyesim se çka do të kishte qenë e mundshme; por, nëse i zbatojmë këto shqyrtime mbi shoqëritë aktuale – dhe nëse i zbatojmë ato mbi shoqëritë e kaluara, përse të mos e bëjmë edhe për shoqëritë aktuale! – dalim në një rrugë pa krye: si do të mund të jepte sociologu këshilla për reforma nëse institucionet më çnjerëzore janë të pashmangshme?

Kështu, më duket se këto tekste mund të kuptohen vetëm me kusht që të pranojmë se shpjegimet e institucioneve me anën e mjedisit gjeografik janë të llojit që një sociolog modern nuk do t’i quante lidhje e domosdoshme shkakësore, por lidhje ndikimi. Njëfarë shkakut bën që një institucion të jetë më i mundshëm se një tjetër.

Përveç kësaj, puna e ligjvënësit shpeshherë ka për qëllim: t'i pengojë ndikimet e drejtpërdrejta të fenomeneve natyrore, të fusë në indin e determinizmit ligje njerëzore, efektet e të cilave kundërshtojnë efektet e drejtpërdrejta, spontane të fenomeneve natyrore.<sup>13</sup> Monteskjë i beson më pak se (nga) ç'është thënë një determinizmi të rreptë të klimës. Në pastë pranuar, si shumë të tjerë në kohën e tij dhe në mënyrë tepër të thjeshtë, se temperamentit dhe ndjeshmëria e njerëzve është drejtpërsëdrejti punë klime, në pastë provuar, nga ana tjetër, të vërë marrëdhënie gjase ndërmjet të dhënave të jashtme dhe disa institucioneve, ai e ka pranuar edhe shumësinë e shkaqeve dhe veprimin e mundshëm të ligjvënësit. Kështu, përimitet e tij shprehin kuptimin se mjedisi nuk i përcakton institucionet, por ndikon tek ato dhe ndihmon në orientimin e tyre në një drejtim të caktuar.<sup>14</sup>

Gjatë shqyrtimi të përcaktuesve të tjerë, Monteskjë pyet veten për numrin e banorëve në krahasim me zejet<sup>15</sup> dhe shtron problemin themelor për ne, atë të vëllimit të popullsisë, i cili varet sigurisht nga mjetet e prodhimit dhe organizimi i punës.

Në një mënyrë të përgjithshme, numri i banorëve varet nga mundësitë e prodhimit bujqësor. Në një bashkësi të caktuar mund të ketë po aq njerëz sa mund të ushqejnë bujqit. Megjithatë, në qoftë se toka punohet më mirë, bujqit janë në gjendje jo vetëm të ushqejnë vetveten, por të ushqejnë edhe njerëz të tjerë. Për më tepër, duhet që bujqit të duan të prodhojnë më shumë se ç'është e nevojshme për jetesën e tyre. Prandaj, bujqit duhen nxitur për të prodhuar sa më shumë dhe duhet inkurajuar shkëmbimi ndërmjet të mirave që prodhojnë zejet ose industria në qytete dhe të mirave që prodhohen në fshatra. Monteskjë nxjerr përfundimin se, për t'i nxitur fshatarët që të prodhojnë, është mirë ta shijojnë kënaqësinë e tepricës.

Ja që edhe këtu ka një ide të vërtetë. Procesi i zhvillimit në vendet e pazhvilluara mund të nisë vetëm duke krijuar nevoja tek bujqit që jetojnë në kushte tradicionale. Duhet të dëshirojnë të kenë më shumë sesa janë mësuar. Mirëpo, thotë Monteskjë, këtë tepricë e prodhojnë vetëm zejtarët.

Por, vazhdon ai: "Ato makina, qëllimi i të cilave është që të shkurtohet punimi i zejtarisë, nuk janë gjithmonë të dobishme. Në qoftë se një punim ka një çmim mesatar dhe i përshtatet njëlloj si atij

që e blen, ashtu dhe punëtorit që e ka bërë, makinat që do ta thjeshtësonin prodhimin e saj, që do ta pakësonin numrin e punëtorëve, domethënë do të ishin të dëmshme dhe po të mos ishin ngritur gjithandej mullinjte me ujë, nuk do të besoja se janë aq të dobishëm sa thuhet, sepse kanë bërë të pushojë një shumicë e madhe krahësh, se kanë privuar shumë njerëz nga përdorimi i ujërave, dhe kanë bërë të humbet pjelloria e shumë tokave". (*Fryma e ligjeve*, lib. XXIII, vep. cit., vëll. II, f. 692).

Ky tekst është interesant. Këto makina, qëllimi i të cilave është që të shkurtrohet punimi i zejtarisë, thënë me një stil modern më të thjeshtë se ai i Monteskjësë, janë ato që shkurtrojnë kohën e punës së nevojshme për prodhimin e artikujve të përpunuar. Monteskjë shqetësohet për atë që ne quajmë papunësi teknologjike. Në qoftë se me ndihmën e një makine i njëjti artikull prodhohet për një kohë të shkurtuar pune, atëherë një numër punëtorësh duhen nxjerrë jashtë procesit të punës. Ai e vret mendjen për këtë çështje, siç e kanë vrarë që prej dy shekujsh njerëzit e çdo brezi.

Sigurisht, ky arsyetim lë jashtë atë që është bërë parim i çdo ekonomie moderne, idenë e prodhimitarisë. Në qoftë se i njëjti artikull prodhohet për një kohë të shkurtër pune, punëtorët e liruar do të mund të përdoren për një punë tjetër dhe kështu do të rritet vëllimi i prodhimeve të lira për gjithë bashkësinë. Ky tekst tregon se autorit tonë i mungon një element i doktrinës, që s'ishte i panjohur në shekullin e tij – enciklopedistët e kishin kuptuar. Ai nuk e ka kuptuar rëndësinë ekonomike të përparimit shkencor e teknik. Ky boshllëk është mjaft i çuditshëm, meqenëse Monteskjë tregonte interesim të madh për zejtarinë dhe shkencat. Ai ka shkruar shumë ese mbi shkencat dhe zbulimet teknike. Por, nuk e ka kuptuar mekanizmin, me anën e të cilit shkurtime i kohës së punës për një prodhim të caktuar mundëson përdorimin e më shumë punëtorëve dhe rritjen e vëllimit të përgjithshëm të prodhimit.<sup>16</sup>

## Shënime

1. Na kujtohet shakaja e hollë, madje shumë e diskutueshme e J. M. Kejnosit në parathënien e tij për botimin francez të *Teorisë së përgjithshme*: “Monteskjë, ekonomisti më i madh francez, ai i cili me të drejtë mund të krahasohet me Adam Smithin dhe i cili i lë në bisht fiziokratët për qartësinë e mendimeve dhe arsyen e shëndoshë (cilësi këto që çdo ekonomist duhet t’i ketë)”. (J. M. Keynes *Théorie générale de l’emploi, de l’intérêt et de la monnaie*, përkthyer nga J. de Largentaye, Paris, Payot, 1953, f. 13).

2. “Ka dallim ndërmjet natyrës së qeverisjes dhe parimit të saj, sepse natyra e saj është ajo që e bën të tillë, ashtu si është, ndërsa parimi është ai që e bën të veprojë. Njëra është struktura e saj e veçantë, ndërsa tjetra pasionet njerëzore që e vënë në lëvizje. Ligjet nuk duhet të lidhen më pak me parimin e çdo qeverisjeje, sesa me natyrën e saj.” (*Fryma e ligjeve*, lib. III, kap. 1, vep. cit., vëll. II, ff. 250 e 251).

3. “Është e qartë se në një monarki, në të cilën ai që bën zbatimin ligjeve vlerëson veten mbi ligjet, ka më pak nevojë për virtytin sesa në një qeverisje popullore, në të cilën ai që bën zbatimin e ligjeve ndien se edhe ai vetë u nënshtrohet atyre dhe do ta bartë peshën e tyre. Kur virtyti pushon së ekzistuari, ambicia hyn në shpirtrat e atyre që mund të kenë prirje për të dhe koprracia bëhet tipar i të gjithëve.” (Lib. III, kap. 3, vep. cit., vëll. II, ff. 251 e 252). “Natyra e nderit do përparësi dhe privilegj” (Lib. III, kap. 7, vep. cit., vëll. II, f. 257).

4. Dallimin themelor ndërmjet republikës dhe monarkisë e gjejmë, ç’është e vërteta, qysh te Makiaveli: “Të gjitha qeverisjet, të gjitha pushtetet e senjorit që sunduan dhe sundojnë njerëzit, qenë ose janë Republika dhe Principata.” (*Le Prince*, kap. 1, vep. cit., Pléiade, f. 290).

5. Për këtë çështje të shihet libri i F. T. H. Fleçerit, *Montesquieu and English politics*, Londres, 1939, të cilit mund t’i bashkohet vepra e P. M. Spurlinit, *Montesquieu in America 1760-1801*, Louisiana State University, 1940.

6. Tekstet e Lokut mbi të cilat punon Monteskjë janë ato të *Two Treatises of Government* (...) të botuara për herë të parë më 1690. Eseja e dytë e këtyre traktateve, *Ese mbi zanafillën e vërtetë, shtrirjen dhe fundin e*

*pushtetit civil*, u përkthye në frëngjishte nga David Mazell dhe u botua në Amsterdam nga A. Wolfgang qysh më 1691, me titullin *Mbi qeverisjen civile*, ku trajtohen origjina, bazat, natyra e pushtetit dhe qëllimet e shoqërive politike. Përkthimi i Mazellit pati botime të shumta gjatë shek. XVIII. Një përkthim i ri për një botim modern u bë nga J. L. Fyot me titullin *Ese mbi pushtetin civil* dhe u botua në Bibliotekën e Shkencës Politike, Paris, P. U. F. 1953, parathënia e B. Mirkine-Geutzevitch dhe Marsel Prelot.

Teoria e pushteteve dhe e marrëdhënieve ndërmjet pushteteve e Lokut është parashtruar në kapitujt 11 dhe 14 të *Esesë mbi pushtetin civil*. Në kapitullin 12, Loku dallon tre lloje të pushtetit: pushtetin ligjvënës, pushtetin ekzekutiv dhe pushtetin federativ të shtetit. "Pushteti ligjvënës është ai që ka të drejtën e përcaktimit të mënyrës në të cilën do të përdoret forca shtetërore për të mbrojtur bashkësinë dhe anëtarët e saj". Pushteti ekzekutiv është "një pushtet në shërbim të përhershëm për t'u kujdesur për zbatimin e ligjeve që janë nxjerrë dhe që mbesin në fuqi." Ai përfshin në të njëjtën kohë administratën dhe drejtësinë. Përveç kësaj, "në çdo shtet ekziston një pushtet tjetër, që mund të quhet natyror, sepse i përgjigjet një të drejte që nga natyra kishte çdo njeri para se të bëhej anëtar i shoqërisë... E vështruar në përgjithësi, bashkësia formon një trupë që ndodhet në gjendje të natyrshme në krahasim me të gjitha klasat e tjera shoqërore, ose me të gjithë personat e tjerë që s'janë pjesë e tyre. Ky pushtet përfshin të drejtën e paqes dhe të luftës, të drejtën për të themeluar lidhje dhe bashkime dhe për të udhëhequr çdo lloj negociatash me personat dhe bashkësitë jashtë shtetit. Mund të quhet po deshëm federativ... Të dy pushtet, ekzekutivi dhe federativi, janë, pa dyshim, realisht në vetën e tyre të ndryshëm: "njëri ka të bëjë me zbatimin e ligjeve brenda shoqërisë, brenda gjithë atyre pjesëve që e përbëjnë; tjetri është i ngarkuar me sigurinë dhe interesat e jashtme të bashkësisë për sa u përket atyre që mund t'i sjellin dobi ose dëme; megjithatë, këto dy pushtete janë, në fakt, pothuajse gjithmonë të bashkuara... Pushteti ekzekutiv dhe pushteti federativ nuk mund t'u besohen personave që mund të veprojnë veças, sepse forcat e rendit do të viheshin në këtë rast nën urdhra të ndryshëm, çka mund të shkaktonte, herët a vonë, vetëm çrregullime e mynxyra." (bot. Fyot, ff.158 e 159).

7. Ky kuptim nuk është tërësisht i ri. Interpretimi i Kushtetutës Romake, nëpërmjet idesë së ndarjes dhe baraspeshës së pushteteve dhe forcave shoqërore, gjendet në teorinë e regjimit të përzierë të Polibit dhe të Ciceronit. Dhe, këta autorë, pak a shumë shprehimisht, shihnin në këtë ndarje dhe në këtë baraspeshë një kusht të lirisë. Mirëpo, pikërisht te Makjaveli mund të lexohen formulime që paralajmërojnë ato të Monteskjësë. "Mbaj krahun e atyre që dënojnë grindjet e Senatit dhe të popullit, të cilët dënojnë atë që qe parimi i lirisë dhe të cilëve u kanë bërë përshtypje më shumë britmat e zhurma që shkaktonin në sheshin publik, sesa efektet e mira që bënin. Në çdo republikë ka dy parti: "ajo e të mëdhenjve dhe ajo e popullit, dhe të gjitha ligjet që janë në dobi të lirisë dalin vetëm nga kundërshtitë e tyre." (*Discours sur la Première Décade de Tite-Live*, lib. I, kap. 4, vep. cit., Pléiade, f. 390).

8. Tema e ndarjes së pushteteve është një nga temat kryesore të doktrinës kushtetuese zyrtare të gjeneral Dë Golit. "Të gjitha parimet dhe të gjitha përvojat kërkojnë që pushtetet publike: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, të jenë të ndarë në mënyrë të qartë dhe shumë të ekuilibruar." ("*Discours de Bayeux*", më 16 qershor 1946). "Le të ekzistojë një qeveri që do të krijohet për të qeverisur, së cilës i lihet koha dhe mundësia e qeverisjes, e cila nuk merret me diçka tjetër përveç punës së vet dhe e cila, nëpërmjet kësaj, meriton pëlqimin e vendit. Le të ekzistojë një parlament i destinuar për të përfaqësuar vullnetin publik të kombit, për të votuar ligjet, për ta kontrolluar ekzekutivin, pa mëtuar të dalë jashtë rolit të vet. Le të bashkëpunojnë qeveria dhe parlamenti, por le të mbesin të ndara për sa u përket përgjegjësi të tyre dhe asnjë anëtar i njërit të mos mund të jetë anëtar i tjetrit. E këtillë është struktura e ekuilibruar që duhet të ketë pushteti... Le të sigurohet pavarësia e autoritetit gjyqësor dhe le të mbesë roje e lirisë së secilit. Kompetenca, dinjteti, paanësia e shtetit do të garantohen më mirë." ("*Discours de la Place de la République*", 4 shtator 1958). Të shënojmë, megjithatë, se në rastin e Kushtetutës së vitit 1958, ekzekutivi mund ta ndalojë legjislativin më lehtë se legjislativi mund ta ndalojë ekzekutivin.

Për interpretimin nga juristët të teorisë së ndarjes së pushteteve të Monteskjësë, të shihet veçanërisht: L. Duguit, *Traité de Droit*

constitutionnel, vëll. I; R. Carré de Malberg, *Contribution à la théorie générale de l'Etat*, Paris, Sirey, vëll. I, 1920, vëll. II, 1922, notamment t. II, ff. 1-142; Ch. Ersenmann, *L'Esprit des lois et la séparation des pouvoirs*, in *Mélanges Carré de Malberg*, Paris, 1933, f. 190, sq.; "La pensée constitutionnelle de Montesquieu", in *Recueil Sirey du Bicentenaire de L'Esprit des lois*, Paris, 1952, ff. 133-160.

9. Ky interpretim është sidomos ai i L. Altuserit në librin e tij "Montesquieu, la politique et l'histoire" Paris, P. U. F., 1959, 120 f.

10. Përveç kësaj, në analizën e republikës, sipas Monteskjesë, me gjithë mendimin thelbësor se natyra e republikës është barazia e qytetarëve, gjendet dallimi ndërmjet masës së popullit dhe elitave.

11. Didëroja, enciklopedistët, sidomos Volteri, mbrojtës i Kalasit, i Sirvenit, i kalorësit La Barë dhe i viktimave të tjera të drejtësisë së asaj kohe, autor i *Essai sur la probabilité en fait de justice* (1772), dëshmojnë për interesimin e madh që nxitën çështjet penale në shek. XVIII. Kulmin e debatit penal e shënon, megjithatë, botimi, më 1774, i veprës *Traité des délits et des peines* i milanezit Çesare Bekaria (1738-1794). Kjo vepër, të cilën autori e shkroi në moshën 26 vjeçare, u komentua menjëherë në tërë Evropën, veçanërisht nga Morëleu, Volteri e Didëroja. Traktati i Bekarias zhvillon mendimin se dënimi duhet të bazohet jo mbi parimin *restitutio juris*, por mbi parimin relativist e pragmatik të *punitur ne peccetur*. Përveç kësaj, ai kritikon në mënyrë rrënjësore procedurën – ose mungesën e procedurës – penale të epokës dhe kërkon që ndëshkimi të jetë në përputhje me krimet. Kjo vepër themelon kriminologjinë moderne dhe është burim i drejtpërdrejtë i reformave të mëvonshme në fushën e së drejtës penale. (shih M. T. Maestro, *Vollaire and Beccaria as reformers of criminal law*, New York, 1942).

12. Për çështjen e ndikimeve mbi Monteskjenë, duhet t'u drejtohem punimeve të J. Didjesë, njëri nga komentuesit më kompetentë të Monteskjesë: *Montesquieu et la tradition politique anglaise en France. Les sources anglaises de L'Esprit des lois*, Paris, 1913.

13. Kapitulli i 5 i librit XIV ka si titull: "Ligjvënës të këqij janë ata që kanë favorizuar të metat e klimës, ndërsa të mirë janë ata që i kanë kundërshtuar ato": "Sa më shumë që shkaqet fizike i shtyjnë njerëzit



të pushojnë, shkruan Monteskjë, aq më shumë shkaqet morale duhet t'i largojnë." (Vep. cit, vëll. II, f. 480).

14. Teoria e ndikimit të klimës i jep shkas një numri vërejtjesh të çuditshme dhe qesharake të Monteskjësë. Gjithnjë me mendje tek Anglia, ai përpiket kështu të vërë në dukje veçantitë e jetës angleze dhe të klimës së ishujve britanikë. Dhe nuk arrin ta bëjë këtë aq lehtë:

"Një kombi, të cilit një sëmundje e shkaktuar nga klima ia prek aq shumë shpirtin, saqë do të mund t'i neveritej gjithçka, deri dhe jeta, shihet qartë se njerëzve, të cilëve gjithçka do t'u ishte e padurueshme, do t'u përshtatej më së miri qeverisja, ku ata nuk do të mund të shfrynin kundër një njeriu të vetëm për sëndisjen e tyre dhe ku, meqë ligjet qeverisin më shumë se njerëzit, për ta ndryshuar shtetin do të duhej vetë t'i përmbysnin ato." (*Fryma e ligjeve*, lib. XIV, kap. 13, vep. cit., vëll. II, f. 486).

Kjo fjali e ndërlikuar duket se do të thotë se klima e Anglisë i shpie njerëzit deri në atë shkallë dëshpërimi, saqë është dashur të hiqet dorë nga qeverisja e një të vetmi me qëllim që hidhërimi i natyrshëm i banorëve të ishujve britanikë të mund të shfrynte vetëm kundër tërësisë së ligjeve e jo kundër një njeriu të vetëm. Përimtimi i klimës së Anglisë vazhdon në këtë stil gjatë disa paragrafëve: Dhe, në qoftë se i njëjti komb do të kishte marrë edhe nga klima njëfarë karakteri padurimi, çka s'do t'i lejonte të kapërdinte për një kohë të gjatë të njëjtat sende, atëherë shihet qartë se qeverisja për të cilën sapo folëm do të ishte akoma më e përshtatshme." (Po aty). Mungesa e durimit të popullit britanik është, domethënë, në harmoni të hollë me regjimin, ku gjyqtarët, për shkak se nuk kanë mundësi të shfryjnë kundër një pushtet-mbajtësi të vetëm, janë, në njëfarë mënyre, të paralizuar për të shprehur padurimin e tyre. Në librat mbi klimën, Monteskjë shumëfishon formulimet e kësaj natyre, të cilat janë, siç thuhet në raste të ngjashme, më shumë të bukura sesa bindëse.

15. Fjala zejtari është marrë në kuptimin e veprimtarisë artizanale. Bëhet fjalë domethënë për veprimtaritë që sot i quajmë të dorës së dytë, të cilat kanë të bëjnë me prodhimin e sendeve, me transformimin e tyre, jo me punimin e tokës.

16. Do të ishte e padrejtë të përmblihdeshin përimtimet ekonomike të Monteskjësë në këtë lajthitje të vetme. Në të vërtetë, Monteskjë

paraqet një pasqyrë përgjithësisht të hollësishme dhe, më të shumtën e herës, të saktë të faktorëve që luajnë rol në zhvillimin e ekonomive.

Si ekonomist, ai është pak sistematik. Nuk i përket as shkollës merkantiliste, as shkollës fiziokratike. Por, mund të quhet, siç e kanë quajtur në kohë të fundit, sociolog që i ka paraprirë studimit modern të zhvillimit ekonomik, pikërisht sepse ka marrë parasysh faktorë të shumë të veprues. Ai përimiton punën e fshatarëve, vetë themelimin e jetës së bashkësive. Bën dallimin ndërmjet sistemeve të pronës, kërkon pasojat e sistemeve të ndryshme të pronës sipas numrit të punëtorëve dhe sipas rendimentit të kulturës, lidh sistemin e pronës dhe punën bujqësore me vëllimin e popullsisë. Pastaj, ai lidh vëllimin e popullsisë me diversitetin e klasave shoqërore. Skicon një teori që mund të quhet teoria e luksit. Duhet klasa të pasura për të përparuar tregtia me gjëra të padobishme, gjëra të cilat nuk përputhen me nevojën e domosdoshme për jetesë. E lidh tregtinë e brendshme ndërmjet klasash të ndryshme shoqërore me tregtinë e jashtme të bashkësisë. Fut ndërhyrjen e parasë, përcjell rolin e parasë në transaksione brenda bashkësive dhe ndërmjet tyre. Së fundi, kërkon të gjejë në ç'masë një regjim i caktuar politik përkrah apo jo mbarësinë ekonomike.

Bëhet fjalë për një përimitim më pak të pjesshëm dhe më pak skematik sesa ai i ekonomistëve në kuptimin e ngushtë të fjalës. Ambicia e Monteskjës është të bëjë një sociologji të përgjithshme që përfshin teorinë ekonomike në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Në këtë mënyrë përimitimi, elemente të ndryshme ndikojnë gjithmonë në mënyrë të ndërsjellë. Lloji i pronës kundërvepron mbi cilësinë e punës bujqësore dhe kjo e fundit kundërvepron pastaj mbi marrëdhëniet e klasave shoqërore. Struktura e klasave shoqërore vepron mbi tregtinë e brendshme dhe të jashtme. Ideja kryesore është ajo e veprimit të ndërsjellë të pakufishëm të sektorëve të ndryshëm grupimesh të ndryshme të tërësisë shoqërore.

**(Përfundon në numrin ardhshëm)**